



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.68/12 prot.

Tiranë më 17.03.2023

VENDIM

Nr. 08, datë 17.03.2023

**PËR KONTROLLUESIN “CANADIAN KINDERGARTEN TIRANA – KJL&CO
SHPK”**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO shpk” (në vijim “Kontrolluesi”).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 34, datë 22.02.2023, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i zbatimit të detyrimeve të lëna në Urdhrin nr.12 datë 26.01.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kontrolluesin “Canadian Kindergarten Tirana – KJL&CO shpk”, si dhe verifikimi i një ankese të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L22622402B dhe ushtron aktivitet në fushën e edukimit parashkollor privat, çerdhe, kopsht gjithashtu dhe aktivitete në fushën e mësimdhënies dhe edukimit.

Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur vijim-ankesa e subjektit E.H. nëpërmjet të cilës pretendon se nga ana e Kontrolluesit edhe pas daljes së Urdhrit nr.12 datë

26.01.2023 të Komisionerit, nuk janë marrë masa për fshirjen e të dhënave personale fotografi/video të fëmijës së saj, të ngarkuara dhe publikuara në llogaritë e biznesit në rrjetet sociale facebook (*Canadian Kindergarten - Tirana*) dhe Instagram (*canadian.kindergarten_tirana*).

2. Konstatohet se Kontrolluesi pasqyron në llogaritë e biznesit të krijuara në rrjetet sociale facebook (*Canadian Kindergarten - Tirana*) dhe Instagram (*canadian.kindergarten_tirana*), aktivitetet edukative, kulturore, festa, etj., nëpërmjet publikimit të fotografive dhe videove të fëmijëve të kopshtit.

Konstatohet se Kontrolluesi nuk aplikon marrjen e pëlqimit ndaj prindit të fëmijës/kujdestarit ligjor, për publikimin e fotografive/videove të fëmijëve në rrjetet sociale që administron, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive/videove të nxënësve në platformat "Facebook" dhe "Instagram" në rastin konkret, pa marrë paraprakisht "Pëlqimin" me shkrim të prindit ose kujdestarit ligjor, bie në kundërshtim me nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

3. Sa i përket përmbushjes së detyrimeve sipas Urdhrit nr. 12, datë 26.01.2023 të Komisionerit, nga verifikimet e llogarive në rrjetet sociale në facebook (*Canadian Kindergarten - Tirana*) dhe instagram (*canadian.kindergarten_tirana*), si dhe konstatimet në vend gjatë hetimit administrativ, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa për të realizuar fshirjen e të dhënave personale, fotografi / video të të gjithë fëmijëve, brenda afateve të përcaktuara në këtë Urdhër.

Konstatohet se në llogaritë e sipërcituara, vijnë të publikuara disa fotografi në të cilat ndodhet fëmija e ankueses por si dhe fëmijë të tjerë, për publikimin e të cilave nuk është mundur të garantohet pëlqimit i prindërve ose përfaqësuesve ligjor të fëmijëve të mitur, sipas parashikimeve të nenit 6 të ligjit.

4. Konstatohet se Kontrolluesi ka komunikuar në rrugë elektronike me prindërit e fëmijëve, duke kërkuar plotësim dokumentacioni, shoqëruar me hartimin dhe nënshkrimin e një kontrate të re midis palëve. Nga verifikimi i përmbajtjes së kontratës së re si dhe nga komunikimi me përfaqësuesen e Kontrolluesit, konstatohet se në pikën 12 të kontratës së re, është parashikuar një klauzolë e cila parashikon se: *"...prindërit kanë akses në aplikacionin "class dojo" nga ku mund të marrin foto dhe video të aktiviteteve të fëmijëve si dhe mund të ndjekin rrjetet sociale të kopshtit, FB & Instagram, për të parë aktivitetet mësimore dhe argëtuese që zhvillohen në kopsht, të cilat publikohen rregullisht për kënaqësinë e prindërve dhe informacion shtesë."*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, edhe në kontratën e re që aplikon me *“prindin/kujdestarin ligjor”*, Kontrolluesi vijon të mos informojë qartësisht mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale të *“fëmijëve”* të tyre, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit. Klauzola e re e përfshirë në kontratë, nuk i plotëson kushtet për tu konsideruar e plotë, në drejtim të garantimit të pëlqimit dhe informimit të subjekteve të të dhënave sipas parashikimeve të Ligjit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit përmes postës zyrtare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, është paraqitur në seancën dëgjimore, datë 06.03.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe në mënyrë të përmbledhur mbajti qëndrimin se: *“Gabimisht kanë ngelur disa fotografi të fëmijës së ankueses të cilat janë fshirë në ditët në vijim duke realizuar fshirjen e të gjithë fotografive/videove ku shfaqet fëmija i ankueses. Kontrata e rifirmosur e Janar 2023 parashikon njoftimin e prindit për publikimin në rrjetet sociale. Firmosja e kontratës nga ana e prindit, deklaroi automatikisht pëlqimin e tij. Ne nuk kemi marrë kurrë ankesa nga vetë prindërit e fëmijëve për publikimin e fotove, nëse do të administronim padyshim që nuk do të postonim fotot e fëmijëve të tyre. Gjithashtu, kërkohet nga Zyra e Komisionerit, një format tip për marrjen e pëlqimit të ligjshëm.”*

Lidhur me pretendimet e kontrolluesit, sikurse i është sqaruar edhe në përmbajtje të Urdhrit nr.12 datë 26.01.2023, të dhënat personale përpunohen vetëm nëse garantohet njëri prej kriterëve ligjore për përpunimin, i cili në rastin konkret duhet të jetë pëlqimi i prindit të fëmijës ose përfaqësuesit ligjor. Dhënia e këtij *“Pëlqimi”* duhet të plotësojë kërkesat e ligjit, konkretisht duhet garantuar në formë shkresore, i dhënë shprehimisht, me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen përse të dhënat do të përpunohen.

Kur kërkon *“pëlqimin”*, Kontrolluesi duhet të vlerësojë nëse ai i plotëson të gjithë kriteret për të garantuar një *“pëlqim”* të vlefshëm. Nëse është marrë në përputhje me ligjin, *“pëlqimi”* është një mjet që i mundëson subjektit të të dhënave kontroll nëse të dhënat personale të tij do të përpunohen apo jo. Në rast se jo, kontrolli i subjekteve mbi përpunimin e të dhënave, do të ishte imagjinar dhe *“pëlqimi”* do të ishte një kriter ligjor jo i saktë për përpunimin, duke e bërë procesin e përpunimit të paligjshëm

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara, megjithatë, kjo nuk e përjashton Kontrolluesin nga përgjegjësia administrative në rastin konkret, për shkak se detyrimet e përcaktuara në Urdhrin nr. 12, datë 26.01.2023 të Komisionerit, duhet të ishin përmbushur në mënyrë të plotë dhe të saktë, si dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë Urdhër, me qëllim garantimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale për subjektet “fëmijë”.

Njëkohësisht, Kontrolluesi përmes email-it të datës 15.03.2023, drejtuar Zyrës së Komisionerit ripërsërit qëndrimet e mbajtura edhe përgjatë seancës dëgjimore ku në mënyrë të përmbledhur parashtron se “*Në rrjetet tona sociale ne nuk publikojmë fëmijët si individë, pra fytyrat e tyre të veçuara dhe vendosura në fokus të fotografive por ne publikojmë aktivitetet mësimore dhe ekstra kurrikulare të cilat ofrohen nga kopshti. Gjithashtu, gjatë periudhës që fëmija i ankueses ka frekuentuar institucionin tonë, nuk është shprehur asnjëherë asnjë ankesë apo shqetësim në lidhje me këtë çështje.*”

Zyra e Komisionerit vlerëson se argumentet e parashtruara më sipër nga Kontrolluesi, nuk përbëjnë fakte/ apo prova të reja shtesë, në drejtim të zbatimit të detyrimeve të Ligjit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a” dhe “b”, pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) *kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- b) *kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe kriterëve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Gjithashtu, Vendimi i Komisionerit bazohet edhe në faktin që ky kontrollues nuk ka marrë masa për plotësimin e rekomandimeve të lëna në Urdhrin nr. 12, datë 26.01.2023 të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 29, 30, 39 (pika 1, gjerat “a” dhe “b”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkeljet të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;

- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Kontrolluesi të realizojë fshirjen e të dhënave personale fotografi/video të të gjithë fëmijëve, në cilësinë e subjekteve të të dhënave, të publikuara në rrjetet sociale “Facebook” dhe “Instagram”, në të gjitha ato raste që nga ana e Kontrolluesit nuk është garantuar marrja e pëlqimit nga prindërit ose përfaqësuesit ligjor të fëmijëve të mitur;
- 4- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave për të gjitha proceset përpunuese, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
- 6- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - i. brenda 5 (pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 3, më sipër;
 - ii. në vazhdimësi, detyrimet e përcaktuara në pikat 4 dhe 5, më sipër.
- 7- Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
- 8- Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
- 9- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
- 10- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.
- 11- Ky Vendim u shpall sot më datë 17.03.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi